

NJOFTIM-SHPALLJE

PËR SHPREHJE TË INTERESIT PËR MARRJEN E LOKALIT ME QIRA PËR NEVOJAT E DREJTORISË SË ADMINISTRATËS SË KRYEQYTETIT

Për projektin:

“Marrja me qira e një zyre për shërbimet e Gjendjen civile në lagjen “Muharrem Fejza””.

Ftesë për shprehje interesi

Komuna e Prishtinës fton pronarët e lokaleve/hapësirave të interesuarit për marrjen me qira për shfrytëzim të hapësirës, me qëllim të hapjes së zyrës së Gjendjes civile në lagjen “Muharrem Fejza”. Të gjithë të interesuarit që kanë hapësira të përshtatshme për këtë qëllim dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara, mund t’i dërgojnë ofertat e tyre të kompletuara me dëshmitë përcjellëse në e-mailin: Administrata.Pr@rks-gov.net.

Kriteret për kualifikim

Për të qenë pjesë e këtij bashkëpunimi, lokali duhet t’i plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Zyra/hapësira në sipërfaqe minimumi 60m², por jo më shumë se 65m²;
2. Objekti duhet të jetë brenda zonës me rrugë ndërlidhëse të rr. “Muharrem Fejza”;
3. Vendparking për së paku dy automjete;
4. Ngrohje qendrore të qytetit për çdo ditë pune gjatë sezonit të dimrit;
5. Banjë, ujë të ftohtë dhe të ngrohtë;
6. Perde të përshtatshme për zyrë;
7. Klimatizim;
8. Dysheme të shtruar;
9. Certifikata e pronësisë së lokalit;
10. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
11. Deklarata nën betim.

Dokumentacioni që kërkohet prej ofertuesit:

1. Oferta e subjektit për lokalën në posedim;
2. Deklaratë me shkrim e hollësishme për vënien në funksion të objektit;
3. Vërtetim që dëshmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj subjekteve tjera (energjitë elektrike dhe komunalitë e tjera);
4. Vërtetim nga Administrata Tatimore se subjekti i ka shlyer detyrimet tatimore;
5. Vërtetim nga institucioni përkatës që subjekti nuk është në ndjekje penale;
Objekti që do të merret me qira në kohëzgjatje prej një (1) viti, me mundësi vazhdimi deri në 36 muaj;
Objekti duhet të ketë leje ndërtimi dhe pranim teknik.

Procedura e Aplikimit

Pronarët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre së bashku me dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, do të organizohen takime të drejtpërdrejta për të diskutuar më tej mbi propozimet dhe kushtet e bashkëpunimit.

- **Koha e aplikimit:** 09.07.2025 – 29.07.2025.
- **Procedura e dorëzimit të aplikacioneve:** e-maili: Administrata.Pr@rks-gov.net
- **Adresa kontaktuese për informata shpesh:** Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Administratës.
- **Tel:** 038/230-900